



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA FUSHË-ARRËZ
KËSHILLI BASHKIAK

Nr. 4086 prot.

Fushë-Arrëz, më 29.12.2025

VENDIM
Nr. 44, datë 26.12.2025

“PËR
MIRATIMIN E PAKETËS FISKALE PËR VITIN 2026

Bazuar në ligjin Nr.139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore” i ndryshuar, në mbështetje të nenit 54 gërma “f”, nenit 55 pika 3, të ligjit nr.68/2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”, ligjit nr. 9632/2006 “Për sistemin e taksave vendore”, i ndryshuar, në ligjin nr. 9920/2008 “Për procedurat tatimore në R.SH” i ndryshuar, Në ligjin nr. 10081/2009 “për liçensat, autorizimet dhe lejet në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, ligji nr.10304 datë 15.07.2010 “Për Sektorin minerar në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, ligji nr. 9975 datë 28.07.2008 “Për taksën kombëtare” i ndryshuar, ligji nr.152/2015 “Për shërbimin e mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimi”, VKM nr.607 datë 29.07.2020 “Për tarifat dhe llojet e shërbimeve që ofrohen nga shërbimi i mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimi” si dhe VKM Nr. 132, datë 7.3.2018 “për metodologjinë për përcaktimin e vlerës së taksueshme të pasurisë së paluajtshme “ndërtesa”, e bazës së taksës për kategori specifike, natyrën dhe prioritetin e informacionit dhe të dhënave për përcaktimin e bazës së taksës, si dhe të kriterëve dhe rregullave për vlerësimin alternativ të detyrimit të taksës” i ndryshuar; Në bazë të dokumentave të sjella me propozimin e kryetarit të Bashkisë, **Këshilli i Bashkisë Fushë-Arrëz në mbledhjen e tij të datës 26.12.2025**, pas shqyrtimit të propozimeve të paraqitura nga Kryetari i Bashkisë dhe Zyra e Tatim Taksave në Bashkinë Fushë-Arrëz,

VENDOSI

1. Të miratojnë nivelin e taksave dhe tarifave vendore për vitin 2026, sipas materialit bashkëlidhur të këtij vendimi.
2. Të miratojnë ndryshimet e bëra në paketën fiskale 2026 sipas relacionit bashkëlidhur vendimit
3. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Kryetari i Bashkisë, Zyra e Tatim-Taksave pranë Bashkisë Fushë-Arrëz, Njësitë Administrative, Zyra e Financës dhe Dega Thesarit Pukë.

Ky vendim u zbardh me datë **29.12.2025** dhe hyn në fuqi sipas përcaktimeve të pikës 6, neni 55 të Ligjit 139/2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore”, i ndryshuar.

Vendimi u miratua nga Këshilli Bashkiak me:

13 vota pro

0 vota kundër

0 vota abstenim

SEKRETAR

Naze SELIMAJ

KRYETAR

Nikolin BARDHOKU

